

UNIVERSITETI AAB - PRISHTINË

FAKULTETIT JURIDIK

Dekanatit

Programit për Studimet : Master

Emri i Programit te Masterit –Juridik-Penal

Lënda: Kërkesë për lejimin e punimit të diplomës, tezat dhe projekt temën e masterit

Kandidati: Iset Haliti nga Skënderaj

Titulli i Temës: Veprat penale të vjedhjeve të rënda në Komunën e Skënderajt gjatë periudhës 2005-2010

Propozimi për mentor: Prof. Dr. Lulzim Tafa.

Përshkrim i shkurtër i temës: Veprat penale të vjedhjeve të rënda në Komunën e Skënderajt gjatë periudhës 2005-2010

Institucionet shtetërore nuk mund të jenë të indiferente ndaj rritjes drastike të krimeve të vjedhjes. Pasi që ndjeshmëria për sigurinë e operatorëve ekonomikë, gjithsesi, pas çdo serie të rritjes së vjedhjeve, nuk mund të mbetet e njejtë. Ende mbetet e pashpjegueshme mungesa e vëmendjes më të madhe nga ana e institucioneve përgjegjëse, madje përballë shifrave të cilat arrijnë deri në përmasa shqetësuese. Jo më pak alarmante shfaqet situata në lidhje me tendencat “vjedhjeve të rënda” përgjatë periudhës së fundit pesëvjeçare në Komunën e Skënderajt. Këto vepra penale kanë shfaqur prej kohësh një tendencë rritjeje për këtë periudhë kohore e cila do të jetë pjesë e hulumtimit të këtij punimi. Shkaqet që kanë ndikuar në krijimin e kësaj situatë janë të një natyre shumë më komplekse dhe ndoshta i kalojnë edhe suazat e qëllimit të këtij punimi. Megjithatë mungesa e një strategjie të qartë parandaluese, si edhe faktorë të tjerë, si kushtet e vështira ekonomike të ndikuara edhe nga kriza botërore, papunësia në shkallë të lartë, rrethanat post konfliktuale në vend, kanë ndikuar në shkallë të lartë në krijimin e kësaj situatë. Duke u nisur nga këto parakushte dhe në korrelacion me shifrat në rritje për veprat tjera penale, bëri që interesimi im të orientohet pikërisht në hulumtimin e kësaj dukurie, ku përmes një analize sasiore të rasteve të ndodhura në këtë Komunë do të përpiqem të jap një kontribut sado modest në fushën e vjedhjeve të rënda, i cili mbase do t’u hyj në punë institucioneve gjatë krijimit të ndonjë strategjie gjithëpërfshirëse në parandalimin e këtyre veprave penale.

Prishtinë,

Data 07.11.2012

Nënshkrimi i kandidatit

